



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:261132  
Datë: 10.10.2024  
Numri i dokumentit: 06279869

**Ac.nr.8099/23**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve Arsim Hamzaj - kryetar i kolegjit, Frosina Sylejmani dhe Lumni Sallauka - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve B.M., B.K. dhe B.P., nga Vushtrria, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Av.L.T., nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të padisë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë - shujtat ditore, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - dega në Vushtrri, C.nr.556/2022, të datës 31.10.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur më datën **03.10.2024** mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET e pathemeltë** ankesa e të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - dega në Vushtrri, C.nr.556/2022, i datës 31.10.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.556/2022, të datës 31.10.2023, e ka aprovuar në tërësi si e bazuar kërkesëpadinë e paditësve B.M., B.K. dhe B.P., nga Vushtrria dhe është detyruar e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që në emër të kompensimit për ushqim në punë paditësit B.M., për 174 ditë të pranisë në punë, shumën prej 348.00 euro, paditësit B.K., për 135 ditë të pranisë në punë, shumën prej 270.00 euro dhe paditësit B.P., për 123 ditë të pranisë në punë, shumën prej 246.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 09.12.2022 e deri në pagesën definitive, në afatin prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përbarimit me detyrim. Si dhe është detyruar e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që paditësve t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës dhe atë për padi shumën prej 208.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore për padi shumën prej 20.00 euro, apo shumën e përgjithshme prej 228.00 euro,

në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e këtë nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afatin ligjor ka parashtruar ankesë për shkak të *shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e të paditurës, aktgjykimin e ankimuar ta anulojë dhe çështjen të vendos në mënyrë meritore, ose të prish aktgjykimin dhe lëndën të kthejë në rigjykim.

Paditësit përmes përfaqësuesit të autorizuar kanë paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurës, përmes së cilës e ka kundërshtuar të njëjtën, duke propozuar refuzimin e saj dhe vërtetimin e aktgjykimin të gjykatës së shkallës së parë, si dhe të detyrohet e paditura që t'i kompensoj shpenzimet procedurale për hartimin e përgjigjes në ankesë në shumë prej 416 euro.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, e në mbështetje të nenit 194 dhe 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*- Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datën 09.12.2022, në gjykatën e shkallës së parë kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, me objekt të padisë kompensimin e shjrtave, me arsyet si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, pa shqyrtim kryesor të çështjes, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.556/2022, të datës 31.10.2023, me të cilin ka vendosur më decidivisht si në dispozitiv të tij. Në arsyetimin e aktgjykimin të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka arsyetuar se nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura në padi dhe në përgjigjen në padi, gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune te e paditura, përkatësisht mësimdhënës në SH.F.M.U. "Nazmi Zhegrova", komuna e Vushtrrisë, fakt i cili vërtetohet me anë të vërtetimit të lëshuar nga SH.F.M.U. "Nazmi Zhegrova", komuna e Vushtrrisë për paditësin B.M. vërtetim i datës 26.03.2021, për periudhën 08.06.2020 e deri me 26.03.2021, vërtetimin e lëshuar nga SH.F.M.U. "Nazmi Zhegrova" komuna e Vushtrrisë për paditësin B.K. vërtetim i datës 26.03.2021, për periudhën 08.06.2020 e deri me datë 26.03.2021, vërtetimin e lëshuar nga SH.F.M.U. "Nazmi Zhegrova", komuna e Vushtrrisë për paditësin B.P. vërtetim i datës 26.03.2021 për periudhën 08.06.2020 e deri më datë 26.03.2021.

Kontestuese nuk ishte as prania e paditësve në punë, ku nga vërtetimet e lëshuara është vërtetuar se paditësi B.M. ka pasur 174 ditë punë, paditësi B.K. ka pasur 135 ditë punë dhe paditësi B.P. ka pasur 123 ditë punë, e po ashtu kontestuese nuk ishte po ashtu rrethana se e paditura nuk ka bërë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në punë. Lidhur me mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë ka vendosur se duke ju referuar dispozitës së nenit 35

paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021. Vendimin mbi kamatën e ka mbështetur në nenin 382 të LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e ka bazuar në nenin 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (*më gjerësisht si në arsyetim të aktgjykimit të atakuar*).

Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të pretenduara, dhe as në shkeljet nga neni 182 parag.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të së drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare sipas nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 parag.2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të të paditurës se kemi parashkrim sepse Kontrata Kolektive e datës 18.04.2017, ka vlefshmëri 3 vjet, ndërsa padia është paraqitur pas afatit, Gjykata ankimore një pretendim të tillë nuk mund ta pranoj si të bazuar, pasi që kërkesa për kompensimin e ushqimit e paditësve nuk është përfshirë në parashkrim, për faktin paditësit me datën 09.12.2022, kanë paraqitur padi përmes të cilës ka kërkuar kompensimin e ushqimit nga data 08.06.2020 deri me datën 26.03.2021, nga çka rezulton se nga fillimi i periudhës për të cilën kërkohet kompensimi e deri te paraqitja e padisë nuk kanë kaluar më shumë se tri vite, që do të thotë se padia e paditësit nuk është e parashkruar konform nenit 87 të Ligjit të Punës.

Po ashtu gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe faktet vendimtare nuk kanë qenë kontestuese. Nuk ka qenë kontestuese në mes palëve se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht në SH.F.M.U. “Nazmi Zhegrova”, komuna e Vushtrrisë, gjë e cila është vërtetuar me anë të vërtetimeve të lëshuara nga e paditura e të cilat gjendet si provë në shkresat e lëndës, e po ashtu janë vërtetuar edhe ditët e pranisë së paditësve në punë për periudhën për të cilën paditësit kërkojnë kompensimin e ushqimit, përmes vërtetimit të lëshuar nga institucioni në të cilin punon, e i cili gjendet në shkresat e lëndës.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, kjo për arsye se me nenin 90 parag.1 të Ligjit të Punës 03/L-212, të datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve, ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me parag.1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me parag.3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive*

*duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me parag.4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”.*

Po ashtu nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës lidhur me vlefshmërinë e kontratës kolektive në kohëzgjatje prej 3 viteve pasi që pasi që duke u bazuar në dispozitën e nenit 45 të Kontratës Kolektive, ku është përcaktuar se: *“Nga Kontrata Kolektive palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese, e cila tërheqje fillon së zbatuari ditën e nënshkrimit të kontratës së re. Nëse nga Kontrata Kolektive pasi t’i skadojë afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit ...”.* Në rastin konkret, nuk është bërë tërheqja e Kontratës dhe se e njëjta ka vazhduar zbatimin edhe për një vit, saktësisht deri kur është bërë nënshkrimi i Kontratës Kolektive me 22.01.2021, ndërsa edhe me kontratën e re është paraparë kompensimi i ushqimit për ditët e pranisë në punë.

Po ashtu nuk qëndrojnë pretendimet se ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike duke mos hapur shqyrtimin gjyqësor, pasi Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar dispozitën e nenit 398 të LPK-së i cili shprehimisht përcakton *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.* Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur ka gjykuar këtë çështje kontestimore pa shqyrtim kryesor të çështjes pasi janë plotësuar kushtet ligjore në rastin konkret.

Me nenin 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021 parashihet se *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucione arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”.* Edhe sa i përket vlerësimit të kohëzgjatjes së kontratës është bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.40/2023, të datës 27.02.2023, ku është theksuar se *“Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, aplikohet në periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri më 21.01.2021”.* Ndërsa, kjo gjykatë shton se për periudhën prej datës 22.01.2021 e deri më datë 26.03.2021, vlen dispozita e nenit 35 par.7 e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021 e cila në mënyrë të njëjtë ka paraparë kompensimin e punëtorëve për shujtat ditore Andaj mbi bazën e të lartcekurave, kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, për çka edhe vendosi që të njëjtin ta vërtetoj sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendosjes lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së paditëses që në emër të kompensimit të ushqimit ditor-shujtës, për periudhën për të cilën paditësit

kërkojnë kompensimin, t'ia kompensojë shumën e aprovuar si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Gjithashtu edhe për lartësinë e kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe në mënyrë të ligjshme, pasi që në shkresat e lëndës ka pasur prova të mjaftueshme, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozita e LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifat për shpenzime gjyqësore. E drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë edhe sa i përket kërkesës aksesore përkitazi me kamatën.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.8099/23, datë 03.10.2024**

**Kryetari i kolegjit - gjyqtari**  
**Arsim Hamzaj**